



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 1605/005
Datë 06.11.2017

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 3.11.2017, mori:

VENDIM

Kompensimi i stafit akademik me mbinormë dhe honorar do të bëhet në përputhje me raportin e orëve të realizuara gjatë semestrit të caktuar, por jo më shumë se fondi i orëve të përcaktuara për vit akademik sipas Rregullores në fuqi për të ardhura personale në UMIB.

Arsyetim

Këshilli Drejtues, duke pasur parasysh propozimin e Senatit që kompensimi i stafit akademik me mbinormë dhe honorar të bëhet në përputhje me raportin e orëve të realizuara gjatë semestrit të caktuar, por jo më shumë se fondi i orëve të përcaktuara për vit akademik sipas Rregullores në fuqi për të ardhura personale në UMIB, e konsideroi të arsyeshëm propozimin, për arsye se fondi i orëve mbinormë dhe honorar për semestër, në bazë të Rregullores për të ardhura personale është 6+6, përkatësisht 5+5. Ndërkohë, realizimi i orëve bëhet në bazë të planprogramit mësimor, që do të thotë se për një semestër mund të realizohen më shumë se 6, përkatësisht 5 orë, ndërsa në semestrin tjetër diferenca e orëve të mbetura, ose më pak, varësisht prej planprogramit mësimor. Bazuar në këtë që u cek më lartë, Këshilli Drejtues e konsideron të arsyeshme që realizimi i pagesave të bëhet sipas realizimit të orëve gjatë një semestri, por pa tejkaluar fondin e plotë të orëve për vit akademik, ashtu siç parashihet me Rregulloren për të ardhura personale, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Fakulteteve,
3. Shërbimit të studentëve në UMIB
5. Shërbimi financiar,
3. Zyrtarit Ligjor.



Dr. sc. Sabri Sadiku

Kryesues i Këshillit Drejtues